

VIII/363

HYLLI I DRITËS

Ubi Spiritus Domini, ibi libertas.
(II. ad Cor. III. 17).

VOTER
KULTURE
SHQYPTARE

10-11

Tetuer-Nanduer 1940 - XIX.
VJETI XVI.

S H K O D E R

Abonimi per „HYLLI I DRITËS“				
Shqypni	Nji numer	Fr. 0.80	Nji vjetë	Fr. 7.—
Itali	» »	» 0.50	» »	» 7.—
Nder vende tjera . . .	» »	» 1.20	» »	» 10.—

Administratori: A. B. Dema

PERMBAJTJA

*) — 28 Nanduer	FAQR 425
P. ANTON HARAPI — Babuui e Bepini	429
GEGË TOSKA — JERINA a se mbretnesha e lulevet	438
Dr. INJAC GJ. NDOJA — Gjelogjija e Shqipnis	465
P. BENEDIKT DEMA — SINODI ITALO-SHQYPTAR e fjalimi i rasës i Shëjtnis së Tij Papës Piut XII	477
A. VIKTOR VOLAJ — Prej letratyres Italjane	485
D. ALEKSANDER SIRDANI — Frazellogji	495
Pr FILIP FISHTA — Gjurmimet e nji muejit në Romë	498
GELASIUS — Fjalori toponomastik	516
RIVISTA E SHTYPIT — p. p.	523
P. D. KURTI — Prralla. — Blë. II. Fash. 1	

HYLLI I DRITËS

E PERKOHSHME KULTURALE-LETRARE

„28 NANDUER“

425

Nierit, posë se per eksistencë të veten, per kurr gjasend tjetër s' i lakon zëmra më fort se per liri.

Shqyptarët e verit të Shqypnis, kúr ligen me dekë, para se me dhanë shpirt, e kan zanát me u dá gjíndjet, miqvet e dashamirvet me ket urim: Lirë e bekue! — si me thanë: ndëjshi gjithmonë të lirë e gjithmonë mirë me Zotin! —

Tue marrë, tash, para sýsh ndiesín e fortë qí Shqyptarët kan ndaj lirin, pa dyshim, datat më në shëj per të në historin e Shqypnis janë këto dyja: *vjeti 1478*, në të cillin hini Turku në Shqypni e mbaroi lirlja e Shqyptarvet; e *vjeti 1912*, në të cillin Shtetet balkanikë dbuen Turkun prej Shqypnije, e Pushtetet e Europës, me 28 Nanduer të këtij vjeti, proklamuen Shqypnin Shtet të lirë e të pamvarshem. Prandej këto dy data, kú me fjalë e msim e kú me shkrim e botim faktesh e datash historike — e jo veç me dokrra të thata — duen rrájosë sa më kthellë në trú e në zëmer të Shqyptarvet e të gjith banorvet të Shqypnis.

E qe se na — mbasi, mjerisht, prej shtúllit të ngushtë të kësaj së perkohshme, nuk mund të pershtrihëmi gjanë e gjatë me shkrime — në ket XXVIII-kryevjetuer të pamvarsis s' onë komtare, po bijm këtu krejt sintetikisht do shinime historike vetëm mbi proklamimin e pamvarsis s' onë komtare që prej vjetit 1912 e mbrapa; e po lámë të dekunt e datës së parë nder vorre.

* * *

Vjetin 1908 komíteti i Zheun-Turqvet në Stambollë merr fuqin e shtetit në dorë, edhe i impozon Turkís konstitucionin.

Me ket punë por Zheun-Turqit as knaqen kristjant as u bënë qefin turqve; veç se, tue shtij politiken n' ushtri, ligsh-tuen edhe më teper Turkin.

E njimend, pa u mbushë vjeti mirë, plasen kryengritjet në Shqypni,

